

## Kategoria Superiore/ Laci – Partizani 1-0

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 14 Shtator 2013 16:55

---



Laci ka marre nje fitore te merituar ne shtepi ndaj Partizanin. Te kuqte kane provuar humbjen e pare ne Superiore edhe pse kane provuar te barazojne rezultatin por pa sukses. Laci ka kerkuar me shume, ka luftuar me shume dhe ne fund eshte shperblyer me nje gol te shenuar nga Tanushi i futur ne fushe si zevendesues. Te kuqte e drejtuar nga Hasan Lika e te mbeshtetur nga tifozet qe kishin udhetuar drejt Lacit kane luajtur jo mire duke qendruar shume te terhequr ne mbrojtje dhe me pas jane thyer pa mundur te shfrytezojne disa kundersizulme. Minuta e 73 ka rezultuar fatale per Partizanin qe eshte ndeshkuar nga Tanushi dhe me pas nuk ka mundur te bej asgje per te barazuar.